

KARTELE INFORMATIVE				
				AL011507
1. Emri i shërbimit	Kërkesë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Nëpërmjet këtij shërbimi aplikantët kanë mundësi të zgjasin afatin për kthimin e përgjigjes ndaj një njoftimi të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) gjatë procedurave të ekzaminimit.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Procedurat e ekzaminimit për regjistrim marke apo për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e markave, përmbajnë afate ligjore të cilat duhet të respektohen. Në rastet e një njoftimi të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), aplikanti ka afate të përcaktuara brenda të cilave duhet të kthejë përgjigje. Në rastet kur aplikanti nuk mund të respektojë këtë afat ka të drejtë të kërkojë zgjatjen e afatit, i cili i mundëson vazhdimin e procedurave të regjistrimit të markës, apo regjistrimin e ndryshimeve të tjera në regjistër, të cilat në të kundërt do të refuzoheshin.			
4. A jam përfutues?	Të drejtën për të aplikuar për markë e ka çdo person fizik apo juridik, shqiptar ose i huaj, përfshirë institucione shtetërore apo organizata jofitimprurëse. Rrjedhimisht, të drejtën për të përfutur nga ky shërbim e kanë këta subjekte, duke qënë se kjo është një procedurë në funksion të regjistrimit të markës apo regjistrimit të ndryshimeve të tjera në regjistër.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Kërkesë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni	Aplikanti / Personi i autorizuar	Po
	2	Mandatpagesa e tarifës përkatëse	Banka	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)	Tiranë	Bulevardi "Zhan D'Ark", Prona Nr. 33, Shtëpia e Usharakëve, Tiranë	E hënë - e enjte, ora 8:00 - 16:30 E premte, ora 8:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	2 000 lekë	Komisioni bankar		Në një bankë (ose në disa banka), jashtë institucionit
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	Pas depozitimit të kërkesës për zgjatje afati dhe pagimit të tarifës përkatëse, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) pret aplikantin të depozitojë dokumentet/plotësimet e tij brenda afatit dy mujor dhe pas këtij afati merr në shqyrtim plotësimet përkatëse, si dhe vendos sipas rastit vazhdimin e procedurës së regjistrimit të markës apo refuzimin e saj për mosparaqitje ose mospranim të dokumentacionit/plotësimeve.			
10. Çfarë përfitoj?	Nuk lëshohet dokument në lidhje me këtë procedurë, por Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) vijon me procedurën e ekzaminimit.			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Nuk lëshohet dokument			
12. Ku e marr?	Në sportele	Me postë	E-albania	Me e-mail
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakt në:		Orari	
	E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPPI web: www.dppm.gov.al Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele	Me postë	Web-i i Institucionit	Me e-mail
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al			
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar; VKM Nr. 315, datë 31.05.2018 "Për miratimin e Rregullores për Markat"; VKM Nr. 883, datë 13.05.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale", i ndryshuar.			